

Republika e Shqipërisë  
Dhoma e Noterisë Tiranë  
Notere Elona L. Saliuj  
Adresa: Blv. "B. Curri", Tiranë  
Tel ++355 4 4324450  
Nr. 1320 Rep  
Nr. 443 Kol 12



Taksa e Pullës u Likuidua

## KONTRATË SHITJE ME REZERVË KUOTE KAPITALI (TË SHOQËRISË "KOSHERJA" SH.P.K)

Sot, më datë 28 Shtator 2018 (*dymijë e tetëmbëdhjetë*), ditë e Premte, para meje Noteres **Elona L. Saliuj**, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë Noterie në Tiranë, Blv. "B. Curri", P. "1 Maji", shk. 9, k.1, u paraqitën personalisht:

### PALA SHITËSE ME REZERVË:

**1. Z. Arvin KITA**, atësia Guri, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Njësia bashkiake nr. 7, Rr. "Nikolla Lena", i datëlindjes 01.10.1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga pasaporta nr. BG3480084 dhe nr. personal H21001147H. (*në cilësinë e shitësit të kuotës së Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës"*).

**2. Zj. Irena KITA**, atësia Andrea, shtetase Shqiptare, lindur në Permet dhe banuese në Tiranë, me adresë Njësia Bashkiake nr. 7, Rr. "Nikolla Lena", e datëlindjes 03.01.1982, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova nga letërnjoftimi nr. personal I25103049A. (*në cilësinë e bashkëshortes së shitësit të kuotës të Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës"*).

### PALA BLERËSE ME REZERVË:

**1. Z. Dorjan KOÇILLARI**, atësia Stavro, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë Njësia bashkiake nr. 7, Rruga "Kongresi i Lushnjes", P. 40, i datëlindjes 18.03.1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga letërnjoftimi H60318060Q.

**2. Z. Elton KOÇI**, atësia Kiço, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. "Kongresi i Lushnjes", p. 40, shk. 7, ap. 76, i datëlindjes 03.07.1977, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga letërnjoftimi nr. personal H70703056S.

**3. Z. Jonis ISAJ**, atësia Shpëtim, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. "Mine Peza", i datëlindjes 03.03.1984, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga letërnjoftimi nr. personal I40303125W. (*në cilësinë e Blerësve të kuotave të Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si Blerës.*)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705, 746, 747, 748 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë

Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë **“KOSHERJA” Sh.p.k.**, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

## NENI 1

### PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

1.1 Shoqëria **“KOSHERJA” sh.p.k.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar si person juridik në QKR (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) me numër Unik Identifikimi të subjektit L81523033M, e themeluar më datë 20/03/2018 dhe e regjistruar më datë 23/03/2018, me seli në Tiranë, Rr. “Jul Variboba”, numër 18. Shoqëria përbëhet nga Ortakët:

- **Z. Dorjan KOÇILLARI**, ortak i shoqërisë **“Kosherja” Sh.p.k.**, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 25 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë);

- **Z. Arvin KITA**, ortak i shoqërisë **“Kosherja” Sh.p.k.**, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 25 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë);

- **Z. Elton KOÇI**, ortak i shoqërisë **“Kosherja” Sh.p.k.**, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 25 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë);

- **Z. Jonis ISAJ**, ortak i shoqërisë **“Kosherja” Sh.p.k.**, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 25 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë).

Shoqëria ka si objekt veprimtarie: *“Aktivitet Bar-Kafe-Restorant; shërbime në fusha të ndryshme etj.....”*

1.2 Objekt i kësaj kontrate është *Shitja me rezervë nga ana e Shitësit* e një kuote, që i përket 25% të kapitalit themeltar, që i korrespondon 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë **“KOSHERJA” Sh.p.k.**, **kundrejt Blerësve** me rezervë, në këtë mënyrë:



- Blerësit me rezervë **Dorjan KOÇILLARI**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket 8.33 % të kapitalit themeltar;

- Blerësit me rezervë **Jonis ISAJ**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket 8.33 % të kapitalit themeltar;

- Blerësit me rezervë **Elton KOÇI**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket 8.34 % të kapitalit themeltar.

Të gjithë Blerësve së bashku u kalon në pronësi me rezervë një kuote, që i përket 25% të kapitalit themeltar, që i korrespondon 2.500,00 (pjesë të zotëruara të Shoqërisë **“KOSHERJA” Sh.p.k.**

1.3 Shitja me rezervë e kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie nga ana e shitësit në masën 25 % gjithsej dhe Blerja me rezervë nga ana e secilit Blerës sipas pjesëve më lart; të cituar në nenin 1.2; të një kuote, që i përket 25% të kapitalit themeltar, si më sipër, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së Shitësit me rezervë mbi këtë kuotë dhe transferimin me të drejta të plota tek secili Blerës me rezervë, **pas likuidimit total të vlerës monetare totale**, ku ortakët blerës **Dorjan KOÇILLARI, Jonis ISAJ** bëhen pronarë në pjesë të barabartë të një kuote, në masën **33.33 %** secili të kapitalit themeltar të shoqërisë, që i korrespondon vlerës **33,333** lekë, pjesë të zotëruara të Shoqërisë nga secili dhe blerësi

Republika e Shqipërisë  
Dhoma e Noterisë Tiranë  
Notere Elona L. Saliq  
Adresa: Blv. "B. Curri", Tiranë  
Tel ++355 4 4324450  
**Nr. Prot. extra**

**VËRTETIM**  
**(Saktësim gabimi material)**

Sot, më datë 05 Shkurt 2019 (*dymijë e nëntëmbëdhjetë*), Unë Notere **Elona L. Saliq**, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë Noterie në Tiranë, Blv. "B. Curri", P. "1 Maji", shk. 9, k.1, lëshoj këtë vërtetim me qëllim saktësimin e një gabimi material në kontratën e shitjes kuote kapitali ( të shoqërisë "Kosherja" sh.p.k") si më poshtë vijon:

Ndërhyrja në Aktin: Kontratë Shitje me Rezervë Kuote Kapitali Nr.1320Rep, Nr.443Kol, datë 28 Shtator 2018, hartuar nga Notere Elona L. Saliq, dhe konkretisht në faqen Nr.1 të kontratës, neni 1, "**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**", pika 1.1, paragrafi i parë, i dytë, i tretë dhe **neni 1.2** tek paragrafi i parë dhe paragrafi i fundit, duke u fshirë togfjalëshi "**pjesë të zotëruara**" dhe duke u zëvendësuar nga fjala "**Lekë**" është bërë nga ana ime në cilësinë e Noteres e cila ka hartuar Aktin

Kjo ndërhyrje është bërë në zbatim të Ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, "Për Noterinë", i ndryshuar, konkretisht Neni 50 "..... Nëse lind nevoja për të hequr fjalë a fjali, ato vihen në kllapa, nënvizohen dhe në vijim përmenden sa fjalë a fjali janë hequr....."

Neni 1, Pika 1.1, paragrafi i parë, dytë, i tretë dhe **neni 1.2** tek paragrafi i parë dhe paragrafi i fundit tek Kontrata e Shitjes me Rezervë Kuote Kapitali Nr. 1320 Rep, Nr. 443 Kol, datë 28 Shtator 2018, hartuar nga unë Notere Elona L. Saliq aktualisht është:

**NENI I**  
**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

**1.1** Shoqëria "**KOSHERJA**" sh.p.k, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar si person juridik në QKR (*Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve*) me numër Unik Identifikimi të subjektit L81523033M, e themeluar më datë 20/03/2018 dhe e regjistruar më datë 23/03/2018, me seli në Tiranë, Rr. "Jul Variboba", numër 18. Shoqëria përbëhet nga Ortakët:

- **Z. Dorjan KOÇILLARI**, ortak i shoqërisë "**Kosherja**" Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i **25 %** të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës **2.500,00 Lekë**.
- **Z. Arvin KITA**, ortak i shoqërisë "**Kosherja**" Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i **25 %** të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës **2.500,00 Lekë**.
- **Z. Elton KOÇI**, ortak i shoqërisë "**Kosherja**" Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i **25 %** të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës **2.500,00 Lekë**.
- **Z. Jonis ISAJ**, ortak i shoqërisë "**Kosherja**" Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i **25 %** të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës **2.500,00 Lekë**.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie: "*Aktivitet Bar-Kafe-Restorant; shërbime në fusha të ndryshme etj.....*".

**1.2** Objekt i kësaj kontrate është *Shitja me rezervë* nga ana e *Shitësit* e një kuote, që i përket **25%** të kapitalit themeltar, që i korrespondon **2.500,00 Lekë** të Shoqërisë "**KOSHERJA**" Sh.p.k., *kundrejt Blerësve* me rezervë, në këtë mënyrë:

Blerësit me rezervë **Dorjan KOÇILLARI**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket **8.33 %** të kapitalit themeltar;

- Blerësit me rezervë **Jonis ISAJ**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket **8.33 %** të kapitalit themeltar;

- Blerësit me rezervë **Elton KOÇI**, i kalon në pronësi një kuotë, që i përket **8.34 %** të kapitalit themeltar.

Të gjithë Blerësve së bashku u kalon në pronësi me rezervë një kuote, që i përket **25%** të kapitalit themeltar, që i korrespondon **2.500,00 Lekë** të Shoqërisë "**KOSHERJA**" Sh.p.k.

Të gjitha kushtet e tjera të Kontratës së shitjes me rezervë kuotë kapitali të shoqërisë "Kosherja" sh.p.k, do të vazhdojnë të jenë të pandryshuara dhe të prodhojnë efektet e tyre ligjore edhe pas këtij vërtetimi.

Ky vërtetim i bashkëngjitet kontratës së shitjes me rezervë kuote kapitali të shoqërisë "Kosherja" sh.p.k datë 28 Shtator 2018, me Nr. Rep. 1320 dhe Nr. Kol. 443, Notere Elona L. SALIAJ, si pjesë e pandarë e saj. Kontrata e shitjes me rezervë kuote kapitali dhe ky vërtetim saktësimi gabimi material do të lexohen dhe interpretohen si një dokument i vetëm. Ky vërtetim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga unë Noterja. Vërtetimi, hartohet në 4 kopje me vlerë të njëjtë juridike për fuqi përdorur dhe paraqitur përpara institucioneve kompetente, për të gjitha efektet e ligjit!

**NOTERE**  
Elona L. SALIAJ

Elton KOÇI bëhet pronar i një kuote në masën **33.34 % të kapitalit** themeltar të shoqërisë, që i korrespondon vlerës **33,334 lekë**, si pasojë e këtij trasanksioni shitje.

1.4 Në këtë mënyrë, me kalimin e pronësisë me anë të kësaj *Kontrate Shitje* me rezervë të kuotës së kapitalit të Shoqërisë "*Kosherja*" Sh.p.k, gjendja e pronësisë së kuotës ndryshon në këtë mënyrë:

- **Shitësi me rezervë Arvin KITA (dhe bashkëshortja Irena KITA), humbet tërësisht pronësinë e një kuote, që i përket 25 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "KOSHERJA" Sh.p.k., pas likuidimit total të vlerës monetare të përcaktuar për shitjen e saj, e vërtetuar me mandat bankar.**

- **Blerësi Z. Dorjan KOÇILLARI, bëhet pronar dhe zotërues i një kuote kapitali, të përbërë nga 33.33 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 33,333 lekë.**

- **Blerësi Z. Jonis ISAJ, bëhet pronar dhe zotërues i një kuote kapitali të përbërë nga 33.33 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 33,333 lekë.**

- **Blerësi Z. Elton KOÇI, bëhet pronar dhe zotërues i një kuote kapitali të përbërë nga 33.34 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 33,334 lekë.**

## NENI 2

### ÇMIMI I SHITJES ME REZERVË DHE MËNYRA E LIKUIDIMIT

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësit i detyrohet Shitësit për blerjen me rezervë të një kuote, që i përket 25 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "*KOSHERJA*" Sh.p.k., është në vlerë monetare gjithsej **2'067'500 Lekë (dy milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind Lekë)**. Vlera monetare e sipërcituar likuidohet me këste, në pjesë të barabarta, nga secili blerës. Vlera monetare e sipërcituar do të likuidohet, me katër këste, në këtë mënyrë:

- **Kësti i parë:** Vlera monetare prej 450'000 lekë (*katërqind e pesëdhjetë mijë lekë*), është likuiduar nëpërmjet bankës Banka "NBG" sh.a., më datë 18 Shtator 2018, nga Blerësit në pjesë të barabarta, me nga 150'000 lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë) secili, në llogarinë bankare të shitësit Arvin Kita PF, me nr. IBAN numër AL28901110510041541810000012.

- **Kësti i dytë:** Vlera monetare prej 450'000 lekë (*katërqind e pesëdhjetë mijë lekë*), do të likuidohet nëpërmjet bankës Banka "NBG" sh.a., në pjesë të barabarta nga Blerësit, me nga 150'000 lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë) secili më llogarinë bankare të shitësit Arvin Kita, me nr. IBAN numër AL49901110510039294410000017, sot më datë 28 Shtator 2018.

- **Kësti i tretë:** Vlera monetare prej 1'050'000 lekë (*një milion e pesëdhjetë mijë lekë*), do të likuidohet nëpërmjet bankës Banka "NBG" sh.a., në pjesë të barabarta, me nga 350'000 lekë (*treqind e pesëdhjetë mijë lekë*) secili, nga Blerësit në llogarinë bankare të shitësit Arvin Kita PF, me nr. IBAN numër AL49901110510039294410000017, brenda datës 31 Tetor 2018.

- **Kësti i katërt:** Vlera monetare prej 117'500 lekë (*njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind lekë*), do të likuidohet nëpërmjet bankës Banka "NBG" sh.a., në pjesë të barabarta, me nga rreth 39'167 lekë (*tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë*) secili nga Blerësit, në llogarinë bankare të shitësit Arvin Kita PF, me nr. IBAN numër AL49901110510039294410000017, brenda datës 20 Dhjetor 2018.


2.2 Me vërtetimin shlyerjes totale të vlerës monetare përfundimtare nëpërmjet faturave bankare, pala shitëse zhvishet tërësisht nga pronësia e kuotës së shoqërisë dhe palës Blerëse i kalojnë në pronësi

pasuria e luajtshme, kuota përkatëse e shoqërisë me të drejta të plota, e lirë nga çdo peng dhe detyrim tjetër.

2.3 Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë lloj pretendimi as tani as në të ardhmen për vlerën e përcaktuar për shitjen e kuotës.

### NENI 3 BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;  
3.2 Kodi Shqiptar i Familjes (neni 73, 74/a e vijues i tij).  
3.3 Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”, me ndryshimet.  
3.4 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet;  
3.5 Ligji nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”; me ndryshimet.



### NENI 4 KALIMI I PRONËSISË ME REZERVË

4.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë Shitje prodhon efektet juridike të parashikuara nga Neni 705, 746, 747, 748 e vijues i Kodit Civil. Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj kontrate, kuotat e shoqërisë mbeten të regjistruara në pronësi të palës shitëse, ndërsa blerësit kanë të drejtë të regjistrojnë kontratën e shitjes me rezervë të kuotave në QKB, ku pronësia me të drejta të plota e kuotës së shoqërisë, kalon tek blerësit dhe pasqyrohen ndryshimet përkatëse në momentin e likuidimit të plotë të vlerës monetare përkatëse. Me likuidimin e këstit të fundit të vlerës monetare për blerjen e kuotës së shoqërisë, pronësia kalon nga shitësi tek blerësit me të drejta të plota, e lirë nga çdo peng apo detyrim tjetër real dhe pa asnjë kusht. Nëse Pala Blerëse është e gatshme për të likuiduar vlerën monetare totale më shpejt se sa afati i përcaktuar për shlyerjen e saj të plotë, atëherë regjistrimi i ndryshimeve të pronësisë bëhet menjëherë me paraqitjen e mandat pagesës nga pala blerëse.

4.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi me rezervë e humbet pronësinë e tij mbi kuotën e kapitalit zotëruar që shet, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim apo përgjegjësi pronësie mbi këtë kuotë në shoqërinë “Kosherja” sh.p.k. ndërsa Blerësit bëhen pronarë të ligjshëm të kuotës sipas specifikimit të nenit 1.4 të kësaj kontrate mbi këtë kuotë, duke e zotëruar atë tërësisht.

4.3 Termat e kësaj kontrate Shitës me rezervë dhe Blerës me rezervë, nuk do të ndryshojnë për sa kohë do të zgjasë marrëdhënia e detyrimit.

4.4 Menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje me rezervë, pala Blerëse ka të drejtë të depozitojë kontratën në QKB, e cila nuk do të kalojë në pronësi të Blerësve, deri në likuidimin total të vlerës monetare sipas kësteve të përcaktuara në këtë kontratë.

4.5 Me likuidimin e këstit të fundit të vlerës monetare të blerjes me rezervë e kuotës së shoqërisë, sipas përcaktimit në këtë kontratë, Shitësi me rezervë zhvishet tërësisht nga pronësia dhe nga çdo përgjegjësi mbi kuotën që shet dhe Blerësit bëhen pronarë sipas përcaktimeve në nenin 1.4 të kësaj kontrate.

### NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1 Për zbatimin dhe realizimin e kësaj kontrate shitje me rezervë kote shoqërie, palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:



#### A. Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit me rezervë:

- *Shitësi* merr përsipër dhe deklaron se kuota e shoqërisë objekt i kësaj kontrate shitje me rezervë, është në pronësinë e tij dhe se këtë kuotë ua shet me rezervë *Blerësve*, me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.
- *Shitësi* me nënshkrimin e kësaj kontrate, shpreh vullnetin për depozitimin e kontratës së shitjes së kuotave në QKB, e cila do të mbetet aty deri në likuidimin e plotë të vlerës monetare për shitjen e kuotës dhe pas shlyerjes totale të saj, do të bëhet regjistrimi dhe kalimi i pronësisë në favor të *blerësve* me të drejta të plota dhe pa asnjë kusht.
- *Shitësi* garanton *Blerësit* se kuota e pasurisë që shet është në pronësi të tij, fakt ky i cili vërtetohet nga ekstrakti i shoqërisë. Gjithashtu, *Shitësi* garanton *Blerësin* se kuota nuk është e rënduar me barrë dhe nuk është lënë peng, apo të drejta të tjera reale në favor të personave të tretë dhe të cilat mund të përbëjnë shkak për mbështetjen e pretendimeve të të tretëve mbi pronësinë e kësaj kuote, të cilat mund të sjellin si pasojë cenimin e të drejtës së pronësisë së *Blerësit*.
- *Shitësi* deklaron se i është bërë likuidimi i kësaj të parë të shitjes së kuotës, vlera prej 450'000 lekë, më datë 18 Shtator 2018 dhe nuk ka pretendime në lidhje me to.
- *Shitësi* bie dakord dhe detyrohet të garantojë *Blerësin* për çdo **Eviksion**, pra të garantojë për moscenimin e së drejtës së pronësisë së kuotës që mund të shkaktohet nga çdo pretendim i ngritur nga persona të tretë. Në këtë aspekt, nëse persona të tretë do të ngrenë pretendime bazuar në të drejta reale të lindura përpara prodhimit të efekteve juridike të kësaj kontrate shitje me rezervë, ose për të drejta të tjera reale të krijuara me dijeni të *shitësit*, ose për të cilat ai nuk mund të mos ishte në dijeni. Në të gjitha rastet, *Blerësi* detyrohet të vërë menjëherë në dijeni *Shitësin* dhe në rast konflikti gjyqësor të mundshëm, të procedojë me thirrjen në gjykim si person i tretë të tij. *Shitësi* është i gatshëm dhe i detyruar të paraqitet menjëherë me kërkesën e palës *Blerëse* dhe të çdo personi tjetër të tretë që pretendon mbi këtë kuotë, para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e palës *blerëse* si pronar i ligjshëm i saj.

#### B. Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit me rezervë:

- *Blerësi*, me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon pronësia me rezervë, depozitohet në QKB, por ndryshimi i pronësisë së saj në QKB do të bëhet pas shlyerjes së kësaj të fundit.
- *Blerësi* deklaron se ka bërë likuidimin kësaj të parë të shitjes së kuotës, vlerën prej 450'000 Lekë më datë 18 Shtator 2018, në llogarinë e shitësit.
- *Blerësi* deklaron se e sot më datë 28 Shtator 2018 do të likuidojë në favor të shitësit, nëpërmjet bankës, kështu e dytë të çmimit të përcaktuar në këtë kontratë për blerjen e kuotës, nëpërmjet bankës në numrin e llogarisë së shitësit.
- *Blerësi* deklaron se shlyerjen e vlerës monetare totale të mbetur për blerjen e kuotës, që përbën kështu e fundit, do të likuidohet brenda datës 20 Dhjetor 2018.
- Në rast se pala *Blerëse*, nuk ka mundësi financiare për likuidimin e të gjithë vlerës monetare të përcaktuar në këtë kontratë ose nuk e likuidon atë brenda afatit dhe kësteve të pacaktuar në kontratë, atëherë ai detyrohet një penaltitet ditor 10'000 Lekë (*dhjetë mijë lekë*).

#### C. Të drejta dhe detyrime dypalëshe:

- Palët kontraktuese deklarojnë se kanë detyrimin për të kryer regjistrimin e kësaj kontrate në QKB.

- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, prona vijon të mbetet në pronësi të shitësit por regjistrohet në QKB Kontrata dhe bëhet shënimi i posaçëm, deri në likuidimin e plotë të vlerës monetare për shitjen e kuotës, sipas specifikave të kësaj kontrate.

5.1 Palët mbeten të lidhura me njëra tjetrën deri në momentin e shlyerjes totale të vlerës monetare të përcaktuar në këtë kontratë

5.2 Pas likuidimit total të vlerës monetare kundrejt palës shitëse, ky i fundit zhvishet tërësisht nga pronësia e kuotës dhe pala Blerëse bëhen ortakë dhe pronarë të Shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k dhe kanë të drejtë të kërkojnë pasqyrimin e ndryshimeve dhe regjistrimin e kontratës në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit), për të bërë ndryshimet përkatëse.

5.3 Nga informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, në rezultatet e kërkimit sipas shkresës bashkëngjitur kësaj kontrate; rezulton se Shoqëria "KOSHERJA" sh.p.k, si dhe ortaku i saj Arvin KITA është e lirë nga çdo barrë e peng mbi kotën e kapitalit.

5.4 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi humbet çdo të drejtë pronësie si dhe çdo të drejtë tjetër për sa i përket pjesës së kuotës takuese të kapitalit të shoqërisë që ua shet Blerësve, duke u kaluar atyre çdo të drejtë dhe përgjegjësi mbi kuotën e shoqërisë.

5.5 Blerësit, si Ortakë të Shoqërisë, kanë të drejtën dhe detyrimin ligjor të respektojnë dispozitat përkatëse për njohjen e shoqërisë, duke marrë përsipër dhe duke njohur çdo të drejtë dhe detyrim të shoqërisë kundrejt të tretëve, si aktivin ashtu edhe pasivin e saj.

#### NENI 6

#### HEQJA DORË NGA TË DREJTAT

6.1 Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate, ai heq dorë tërësisht nga të drejtat që i kanë takuar përgjatë periudhës së zotërimit të objektit të shitjes në shoqëri, apo çdo të drejtë tjetër pa kufizim ku përfshihen të drejta pune, dividendi, asetet, etj.

#### NENI 7

#### REGJISTRIMI I AKTIT NOTERIAL NË QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE


7.1 Palët deklarojnë se morën dijeni për kryerjen e regjistrimit të këtij akti noterial pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) Tiranë, për të bërë njoftimin përkatës dhe njohjen e kontratës. Pas shlyerjes totale të vlerës monetare për blerjen e kuotës, mandat pagesa përkatëse do të depozitohet në QKB, ku do të bëhen ndryshimet përkatëse dhe kalimi i pronësisë sipas kontratës në bazë të Ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### NENI 8

#### INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

8.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

8.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.



6

**NENI 9**  
**LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI,**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

9.1 Kjo kontratë, është redaktuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705, 746, 747, 748 e vijues i tij e vijues të tij si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet.

9.2 Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e tjera të Kodit Civil dhe në Legjislacionin përkatës.

9.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

9.4 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej tyre mund t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**NENI 10**  
**ANEKSET E KONTRATËS**

10.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 2, datë 17 Shtator 2018;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “KOSHERJA” sh.p.k, datë 24 Shtator 2018;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse, marrë nga sistemi e-Albania;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.


**NENI 11**  
**SHPENZIMET E KONTRATËS**

11.1 Shpenzimet për përpilimin dhe redaktimin e Kontratës së Shitjes me rezervë, shpenzimet noteriale dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të të dyja palëve.

**NENI 12**  
**GJUHA E HARTIMIT TË KONTRATËS**

12.1 Kontrata u redaktua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 6 (gjashtë) ekzemplarë, e përbërë nga 8 (tetë) fletë secila, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëri ekzemplar vendoset në arshivën noteriale, një ekzemplar depozitohet në QKR-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) për t’u regjistruar transaksioni i kryer dhe ekzemplarët e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

7





**NENI 13**  
**HYRJA NË FUQI**

13.1 Kjo Kontratë Shitje kuote e kapitalit hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit të palëve në Prani të Noteres, nënshkrimit të saj nga unë Noterja dhe regjistrimit të Kontratës me nr. Repertori dhe Koleksioni në regjistrin Noterial.

**NENI 14**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

14.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

14.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 39 dhe 51 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.


14.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**PALA SHITËSE**

**Arvin KITA**


(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)



**PALA BLERËSE**

**Dorjan KOÇILLARI**

(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)



**Elton KOÇI**


(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)

KOSHERJA SHPK  
NIPT L81523033M



**Irena KITA**

(në cilësinë e bashkëshortes së Shitësit)



**Jonis ISAJ**

(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)



**NOTERE**

**Elona L. SALIAJ**

**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-2018092411384926  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 24.09.2018  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 11:38:49AM  
Lloji i Kerkimit: D-400-314-761  
Numri i Dokumentit:  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI**

ARVIN GURI KITA  
KOSHERJA SH.P.K.



Tiranë, më 17 Shtator 2018

**V E N D I M**  
**I ASAMBLESË SË ORTAKEVE "KOSHERJA" Sh.p.k**  
**datë 17.09.2018**

Sot në Tiranë, më datë 17 Shtator 2018 (*dymijë e tetëmbëdhjetë*), në selinë e Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, shoqëri tregtare, themeluar më datë 20.03.2013 dhe regjistruar më datë 23.03.2018, me seli në Tiranë, Rr. "Jul Variboba", u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, me ortakët e shoqërisë: Dorjan KOÇILLARI, Arvin KITA, Elton KOÇI dhe Jonis ISAJ, me përfaqësues ligjor Elton KOÇI. Shoqëria zotëron një kapital themeltar prej 10'000 Lekë. Asambleja e Ortakëve të kësaj Shoqërie, është mbledhur me këtë rend dite:

1. Për miratimin e nënshkrimit të **kontratë shitje me rezervë kuotash** nga ortaku i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, Arvin KITA tek Ortakët e shoqërisë "Kosherja" sh.p.k: Dorjan KOÇILLARI, Elton KOÇI dhe Jonis ISAJ, në valutën monetare lekë, gjithsej 2'067'500 Lekë (dy milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind Lekë), ku do të likuidohet në pjesë të barabartë nga secili blerës ortak i shoqërisë.
2. Për miratimin e shitjes me rezervë të një kuote të shoqërisë që i përket Arvin Kita kundrejt ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta dhe blerja nga ana e ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta e kuotës së shoqërisë së palës shitëse, në të cilat shlyerja e detyrimit do të bëhet me këste, nëpërmjet bankës, nga pala blerëse kundrejt palës shitëse në llogarinë bankare të palës shitëse dhe do të likuidohet brenda datës 20 Dhjetor 2018.
3. Për miratimin e regjistrimit të kontratës së shitjes me rezervë të kuotave, në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit), kalimi i pronësisë së të cilës dhe pasqyrimi i ndryshimeve përkatëse, do të bëhet me paraqitjen e mandat pagesës së plotë të shitjes së kuotave.
4. Për miratimin e kalimit të pronësisë së kuotave menjëherë pasi të bëhet kalimi i kështit të plotë shitjes së tyre. Caktimin e Z. Elton KOÇI, që të jetë përfaqësues i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, për depozitimin e kontratës së shitjes me rezervë të kuotave, në QKB.


Në këtë mbledhje u thirrën dhe ishin prezent:

1. Z. Dorjan KOÇILLARI, ortak i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, zotërues i numri i pjesëve: 1,00, pjesëmarrja në përqindje (%) 25,00, vlera e kapitalit 2.500,00.
2. Z. Arvin KITA, ortak i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, zotërues i numri i pjesëve: 1,00, pjesëmarrja në përqindje (%) 25,00, vlera e kapitalit 2.500,00.
3. Z. Elton KOÇI, përfaqësues ligjor dhe ortak i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, zotërues i numri i pjesëve: 1,00, pjesëmarrja në përqindje (%) 25,00, vlera e kapitalit 2.500,00.
4. Z. Jonis ISAJ, ortak i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, zotërues i numri i pjesëve: 1,00, pjesëmarrja në përqindje (%) 25,00, vlera e kapitalit 2.500,00.

Pasi çështjet u diskutuan më parë në parim, u kalua në shqyrtim përfundimtar sipas rendit të ditës, ku Ortakët e Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet:

**VENDOSËN:**

1. Miratimin e nënshkrimit të **kontratë shitje me rezervë kuotash** nga ortaku i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, Arvin KITA tek Ortakët e shoqërisë "Kosherja" sh.p.k: Dorjan KOÇILLARI, Elton KOÇI dhe Jonis ISAJ, në valutën monetare lekë, gjithsej 2'067'500 Lekë (dy milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind Lekë). Likuidimi do të bëhet në pjesë të barabarta nga secili blerës, ortak i shoqërisë.



1

2. Miratimin e shitjes me rezervë të një kuote të shoqërisë që i përket Arvin Kita kundrejt ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta dhe blerja nga ana e ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta e kuotës së shoqërisë së palës shitëse., në të cilat shlyerja e detyrimit do të bëhet me këste, nëpërmjet bankës, nga pala blerëse kundrejt palës në llogarinë bankare të palës shitëse dhe do të likuidohet brenda datës 20 Dhjetor 2018.

3. Miratimin e regjistrimit të kontratës së shitjes me rezervë të kuotave, në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit), kalimi i pronësisë së të cilës dhe pasqyrimi i ndryshimeve përkatëse, do të bëhet me paraqitjen e mandat pagesës së plotë të shitjes së kuotave.

4. Miratimin e kalimit të pronësisë së kuotave menjëherë pasi të bëhet kalimi i kështit të plotë shitjes së tyre. Caktimin e Z. Elton KOÇI, që të jetë përfaqësues i shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, për depozitimin e kontratës së shitjes me rezervë të kuotave në QKB.

Pasi u shqyrtuan të gjitha çështjet e rendit të ditës dhe u morën vendimet përkatëse, mbledhja e asamblese së ortakëve të shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k, konsiderohet e mbyllur.

Vendimi i kesaj asambleje u redaktua në 3 (tre) kopje të barasvlefshme dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

**ORTAK I VETËM I SHOQËRISE "KOSHERJA" SH.P.K.**

Arvin KITA

*Arvin Kita*



Dorjan KOÇILLARI

*Dorjan Koçillari*

Elton KOÇI

*ELTON KOÇI*  
KOSHERJA SHPK  
NIPT L81523033M

Jonis ISAJ

*Jonis Isaj*

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L81523033M
2. Data e Regjistrimit	23/03/2018
3. Emri i Subjektit	KOSHERIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	20/03/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/03/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tiranë, Tiranë TIRANE Rruga "Jul Variboba", nr.18
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	4,00
9. Objekti i aktivitetit	A) Aktivitet Bar-Kafe-Restorant; Sherbime në fusha të ndryshme si: Organizini i ekspozitave, konferencave, eventeve të biznesit dhe kulturore, sportive, argetuese, organizim i panairove/eventeve gastronomike, agrobiznes dhe pijeve; Qendra trajnimit profesionale për aktivitetet e rëndësishme të shoqërisë në fushat e kulinarisë, bar-restorant hotelierisë, azileve, shtëpi të fëmijëve dhe gjithçka që përfshin agrobiznesin. B) Importin dhe tregtimin e produkteve shtëpiake dhe përdorim profesional me dy fokus të veçantë në sektorin e turizmit, hotele, spitale, shtëpi banimi, që përfshin shitjet në bare, restorante, hotele, pastrime kimike dhe lavanderi, kafeteri, supermarket dhe qendra tregtare. C) Marrja në menaxhim të parkingjeve, mensave, supermarketeve, qendrave tregtare, sportive, kampingjeve, hoteleve, moteleve, vendpushimeve, parqe argëtimi dhe objekteve turistike në përgjithësi, plazhe dhe hapësira për çlodhje, restorante, bar, edhe me argetime të përafërta, kafene, piceri, bare, restorante, duke përfshirë vete-shërbimin, klube nate dhe salla vëllezimi kinema në vende publike në përgjithësi. Ç) Sherbimet e pastrimit, paketimin e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, ambalazhimit dhe etiketimit të ushqimeve dhe pijeve, trajtimin e ngarkesave dhe paketimeve edhe me ndihmen e transportit gjysmë-mekanike, transport për llogari të tregëtarëve, duhet të theksohet se këto aktivitete do të kryhen në përputhje me

	<p>ligjet dhe rregulloret ne fuqi dhe i nenshtrohen lejeve te nevojshme dhe futjes ne regjistrat dhe per ushtrimin e aktiviteteve apo transaksioneve te nevojshme ne vendin e punes, kompania duhet te mbeshtetet nga profesioniste te jashtem te regjistruar ne pergjegjesine e akredituar profesionale dhe/ose teknike, partneret dhe jo-anetaret qe kane kualifikimet e percaktuara si rezultat i pozicionit te sakte te shprehur nga kompania. Ne kuader te ketyre aktiviteteve shoqeria do te jete ne gjendje te marre apo te japë, perfaqesime, garancite dhe agjenci grant, te importit dhe eksportit te te mirave te lartpermendura, te hape dhe menaxhoje dyqane, pika shitjeje dhe koncesionare, si ne Shqipëri dhe jashte saj, te beje transport per llogari te vet dhe/ose palet e treta. Shoqeria mund te marre pjese ne konkurse, oferta, iniciativa private, procedurave te negociuara, ankande, tendere, kontrata, procedurat per financimin e projektit, te organizuara nga institucionet shteterore dhe publike nga kompani private apo kontraktuese te pergjithshme, organizata, biznese. D) Shoqeria gjithashtu mund te ketë pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri apo ndermarrje te tjera, te cilat kane dy objekt te ngjashem, te perafert ose te lidhur me objektin e shoqerise, te cilat konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per permbushjen e objektit te shoqerise.</p>	
<p>10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit</p>	<p>Elton Koçi Nga: 20/03/2018      Deri: 20/03/2019</p>	
<p>11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>		
<p>12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit 12.2 Numri i pjesëve 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i></p>	<p>DorjanKoçillari Para: 2.500,00      Natyre: 1,00 25,00</p>	
<p>13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i></p>	<p>ArvinKita Para: 2.500,00      Natyre: 1,00 25,00</p>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Ortakët	ArvinKita	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 2.500,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
14. Ortakët	EltonKoçi	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 2.500,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
15. Ortakët	JonisIsaj	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 2.500,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: KOSHERJA Telefon: 0692052679	
18. Statusi:	Aktiv	

Datë: 28/09/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



BANKA NBG ALBANIA S.H.A.

NIPT: J61911008C

1301/III/18261/00863

SHUMA AMOUNT	VAL. CURR.
44501407	All.

MANDAT ARKETIMI / DEPOSIT SLIP

EMRI I DEPOZITUESIT / DEPOSITOR'S NAME :

*Artur Hoxha*

MBAJTESI I LLOGARISE / ACCOUNT HOLDER :

*Arvin Hita P.F*


Nr. LLOGARISE / ACCOUNT No :

*4154181000012*

PERSHKRIM / NARRATIVE:

*Depozitim*

DATA DATE	ORA TIME	NUMRI I LLOGARISE ACCOUNT NUMBER	SHUMA AMOUNT	VAL. CURR.	KODI CODE	ID / TELL. TELL. ID.
28/07/19	13:15	415418100000012	450.140.000	All	DEF	2346
			450.140.000	All	DEF	2346
			450.140.000	All	DEF	2346



FIRMA E AUTORIZUAR  
AUTHORISED SIGNATURE

*(Signature)*

FIRMA E DEPOZITUESIT  
DEPOSITOR'S SIGNATURE

*Artur Hoxha*

*(Signature)*



SHUMA AMOUNT	450.000	VAL. CURR.	ALL
--------------	---------	------------	-----

**MANDAT ARKËTIMI / DEPOSIT SLIP**

EMRI I DEPOZITUESIT/ DEPOZITOR'S NAME:

MBAJTËSI I LLOGARISË / ACCOUNT HOLDER:

Nr. LLOGARISË / ACCOUNT No:

PËRSHKRIM / NARRATIVE:

DATA DATE	ORA TIME	NUMRI I LLOGARISË ACCOUNT NUMBER	SHUMA AMOUNT	VAL. CURR.	KODI CODE	ID I TELL. TELL ID.
01/10/18	11:58	392944-10-000-01-7	450,000.00C	ALL	DEP	9346
DEPOZITIM KOCI ELTON , KOCILLARI						
DORJAN, JONIS ISAJ, PER SHLYERJEN			450,000.00C			
NET						

SHUMA (the figure) / Amount in (words)  
E KESTIT TE 1 TE KUOTES SE ARVIN  
KITA TE SHOQERISE KOSHERJA SHPK  
FOURHUNDREDANDFIFTYTHOUSAND

EMRI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË / NAME OF ACCOUNT HOLDER(S)

KITA ARVIN GURI

24x500  
11x200  
8x100  
450.000

ELTON KOCI

TT 0181

1301/TT/18304/00181

SHUMA AMOUNT	#1,050,000.00	VAL. CURR.	AU.
--------------	---------------	------------	-----

**MANDAT ARKËTIMI / DEPOSIT SLIP**

EMRI I DEPOZITUESIT/ DEPOZITOR'S NAME:

Elton Koci

MBAJTËSI I LLOGARISË / ACCOUNT HOLDER:

Arvin Mita PF

Nr. LLOGARISË / ACCOUNT No:

39294410000014

PËRSHKRIM / NARRATIVE:

Depozitim

DATA DATE	ORA TIME	NUMRI I LLOGARISË ACCOUNT NUMBER	SHUMA AMOUNT	VAL. CURR.	KODI CODE	ID I TELL. TELL ID.
31/10/18	10:17	392944-10-000-01-7 TOT	1,050,000.00C	ALL	DEP	9346
DEPOZITIM KOCI ELTON, KOCILLARI DORJAN, JONIS ISAJ, PER SHLYERJEN NET			1,050,000.00C			


ESHTË KREJTUAR NË BANCËN TË DEPOZITUESIT / DEPOSITED IN THE BANK OF THE DEPOSITOR

KITA TE SHQERISE KOSHERJA SHPK ONEMILLIONFIFTYTHOUSAND

140 x 5000  
100 x 2000  
300 x 500

EMRI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË / NAME OF ACCOUNT HOLDER(S)

KITA ARVIN GURI



#1,050,000.00

ELTON KOCI

*(Signature)*

FIRMA E AUTORIZUAR  
AUTHORISED SIGNATURE

FIRMA E DEPOZITUESIT  
DEPOSITOR'S SIGNATURE

SHUMA AMOUNT	+ 117,500.00	VAL. CURR.	ALL
--------------	--------------	------------	-----

**MANDAT ARKËTIMI / DEPOSIT SLIP**

EMRI I DEPOZITUESIT/ DEPOZITOR'S NAME: ELTON KOCI

MBAJTËSI I LLOGARISË / ACCOUNT HOLDER: ARVIN RITA

Nr. LLOGARISË / ACCOUNT No: 392944 100000017

PËRSHKRIM / NARRATIVE: VESTI H; LIMEFUNDIM KUOTE

DATA DATE	ORA TIME	NUMRI I LLOGARISË ACCOUNT NUMBER	SHUMA AMOUNT	VAL. CURR.	KODI CODE	ID I TELL. TELL ID.
21/12/18	10:49	392944-10-000-01-7	117,500.00C	ALL	DEP	9346
DEPOZITIM KOCI ELTON, KOCILLARI COMM						
DORJAN, JONIS ISAJ, PER SHLYERJEN NET			117,500.00C			
E SHUMES (heljele) / Amount in (Words) <u>KËSTITI TE 4 TE KUOTES SE ARVIN</u>						
<u>KITA TE SHOQERISE KOSHERJA SHPK</u>						
<u>ONEHUNDREDANDSEVENTEENTHOUSANDFIVEHUNDRED</u>						

EMRI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË / NAME OF ACCOUNT HOLDER(S): KITA ARVIN GURI

*(Bank Stamp: Banko Amerikane e Investimeve, Teller, Dept 028)*

*(Handwritten notes: 204500, 342000, 1271000, 7118.000, 204380)*

ELTON KOCI

*(Signature)*

K.A. 15233

FIRMA E AUTORIZUAR  
AUTHORISED SIGNATURE

FIRMA E DEPOZITUESIT  
DEPOSITOR'S SIGNATURE

1/2